



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË ENJTE, 7 QERSHOR 2018, TIRANË

PROCESVERBAL

SEANCËN E DREJTON
KRYETARI I KUVENDIT
GRAMOZ RUÇI

(Seanca filloi në orën 10:00)

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 31.05.2018 (neni 44 i Rregullores)

2. Njoftimi i projektligjeve të depozituara në Kuvend (neni 44, pika 3, i Rregullores)

3. Raporti vjetor i veprimtarisë së Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për vitin 2017 (neni 103 i Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)

Shprehet titullari i institucionit (jo më shumë se 60 minuta).

Shprehet për projektrezolutën Komisioni përgjegjës për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Pyetje

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit

4. Raporti vjetor i veprimtarisë së Autoritetit të Medieve Audiovizive për vitin 2017 (neni 103 i Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)

Shprehet titullari i institucionit (jo më shumë se 60 minuta).

Shprehet për projektrezolutën Komisioni përgjegjës për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

Pyetje

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit të projektrezolutës

5. Raporti vjetor i veprimtarisë së Këshillit Drejtues të RTSH-së për vitin 2017 (neni 103 i Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)

Shprehet titullari i institucionit (jo më shumë se 60 minuta).

Shprehet për projektrezolutën Komisioni përgjegjës për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

Pyetje

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË ENJTE, 7 QERSHOR 2018

Diskutime
(Shprehen grupet parlamentare).
Koha e votimit të projektrezolutës
6. Raporti vjetor i veprimtarisë së Komisionit të Prokurimit Publik për vitin 2017 (neni 103 i Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)
Shprehet titullari i institucionit (jo më shumë se 60 minuta).
Shprehet për projektrezolutën Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.
Pyetje
Diskutime
(Shprehen grupet parlamentare).
Koha e votimit të projektrezolutës
7. Projektligji “Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës” (nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)
Pyetje
Shprehet Komisioni përgjegjës për Politikën e Jashtme.
Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Ekonominë dhe Financat.
Diskutime
(Shprehen grupet parlamentare).
Koha e votimit (në parim, nen për nen dhe në tërësi)
8. Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e Lokarnos “Për përcaktimin e një klasifikimi ndërkombëtar për dizenjot industriale”” (nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë absolute)
Pyetje
Shprehet Komisioni përgjegjës për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.
Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.
Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Politikën e Jashtme.
Diskutime
(Shprehen grupet parlamentare.)
Koha e votimit (në parim, nen për nen dhe në tërësi)
9. Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e Vjenës “Për klasifikimin ndërkombëtar të elementeve figurative të markave tregtare”” (nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë absolute)
Pyetje

Shprehet Komisioni përgjegjës për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.
Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.
Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Politikën e Jashtme.
Diskutime
(Shprehen grupet parlamentare.)
Koha e votimit (në parim, nen për nen dhe në tërësi)
10. Miratimi i kalendarit 3 - javor të punimeve të Kuvendit për periudhën 18 qershor – 6 korrik 2018 (neni 27, pikat 3 dhe 4, i Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)
11. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (neni 45 i Rregullores)
Koha e diskutimeve deri në 60 minuta

Gramoz Ruçi - Seancën e deklaroj të hapur.

(Pasi lexon rendin e ditës)

Ju njoftoj se vijon puna në komisionet parlamentare për shqyrtimin e çështjeve të parashikuara për ditën e sotme.

Lidhur me procesverbalin e seancës së kaluar, a ka ndonjë vërejtje? Nuk ka.

Miratohet.

Ju njoftoj se nga Këshilli i Ministrave janë propozuar dy projektligje. Materialet si gjithmonë do t'i gjeni në faqen zyrtare të Kuvendit në internet. Titujt e tyre i keni përpara në tavolinat e punës.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, me raportin vjetor të veprimtarisë së Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për vitin 2017.

Ftoj zonjën Gentiana Sula, kryetare e këtij Autoriteti.

Atëherë, meqenëse zonja nuk ka mbërritur ende, vazhdojmë me raportin vjetor të veprimtarisë së AMA-s për vitin 2017.

Ftoj zotin Gentian Sala.

Gentian Sala - I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Shqipërisë,

Autoriteti i Medieve Audiovizive, në funksionin e rregullatorit të tregut të transmetimeve, ka një ndikim dhe rol të pazëvendësueshëm në drejtim të garantimit të konkurrencës së ndershme, ushtrimit të lirisë së medias, si dhe të drejtës për informimin, edukimin dhe argëtimin e publikut. Performanca e institucionit paraqet një dinamikë pozitive në zbatimin e kuadrit legjislativ në fuqi, në ndjekjen dhe përmbushjen e rekomandimeve të Kuvendit të Shqipërisë vit pas viti, si dhe në fuqizimin e partneritetit me subjektet audio dhe audiovizive në tregun shqiptar.

Duke synuar që në këtë prezantim të bëj një përmbledhje të aspekteve kryesore të performancës së institucionit gjatë vitit raportues 2017, mund të përmend: miratimin e strategjisë 3-vjeçare të Autoritetit, ku pasqyrohen objektivat, përmbushja e funksioneve të institucionit, si dhe parashikimet e të gjitha akteve nënligjore për rregullatorin në proceset dhe zbatimin e ligjit nr. 97/2013.

Strategjia përfshin dy shtylla: dokumentin strategjik dhe planin e veprimit për dokumentin strategjik.

Miratimi i kontratës së shërbimit të transmetimit publik midis AMA-s dhe të RTSH-së është një tjetër dokument shumë i rëndësishëm i Autoritetit. Ky dokument përfshin dy komponentë kryesorë: ndërtimin e platformës me 12 kanale të vetë RTSH-së, si dhe nivelin e mbulimit me sinjal transmetimi në të gjithë territorin e vendit. Zbatimi i kontratës monitorohet nga AMA çdo 6 muaj dhe gjetjet, përfundimet e dy treguesve u përcillen rregullisht drejtuesve të RTSH-së dhe anëtarëve të Këshillit Drejtues.

Nga vlerësimi i zbatueshmërisë së kësaj kontrate, konstatojmë ecuri pozitive për sa i përket ndërtimit të platformës prej 12 programesh. Ndërkohë që lidhur me mbulimin me sinjal të plotë nga ana e RTSH-së ka ende problematika. Nëse sinjali numerik i operatorit është duke ecur shumë mirë dhe pozitivisht, mbulimi me sinjale analoge ende ka probleme. Këto probleme më shumë vijnë nga një historik i marrëdhënieve të RTSH-së me bashki dhe komuna, ku ajo u linte të drejtën këtyre të fundit të bënin mbulimin e sinjalit.

Me drejtuesit e rinj të RTSH-së mund të themi se kemi një frymë shumë pozitive dhe këto probleme janë drejt minimizimit.

Vijimi i procesit të dixhitalizimit ka qenë një nga prioritetet kryesore të AMA-s për vitin 2017, ku edhe u mbyllën transmetimet analoge në qarqet Berat, Korçë dhe në fillim të vitit 2018 edhe në Fier. Impakti në publik është i dukshëm si në sasi, ashtu edhe në cilësi. Në të gjitha zonat ku janë prezent transmetimet numerike, numri i programeve të transmetuara falas për publikun është rritur. Për shembull, në Berat, për momentin kemi 21 programe pa pagesë, ndërkohë që kanë qenë vetëm 9; në Korçë janë 24 programe pa pagesë për publikun; në zonën e Fierit ka 26 programe pa pagesë, ndërkohë që kanë qenë vetëm 8 programe.

Pra, është e dukshme se dixhitalizimi për publikun e gjerë, sidomos për shtresat më në nevojë, ka sjellë një impakt shumë pozitiv.

Gjatë vitit 2017 ka përfunduar procesi i lirimit të brezit të dixhitalit, dividendit dixhital, duke mundësuar kalimin e tij në teknologjinë e komunikimeve të lëvizshme, gjë që do të sjellë të

ardhura të konsiderueshme për buxhetin e shtetit. Lirimi i këtij brezi ka qenë edhe në fokus të rekomandimeve të Bashkimit European, në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Finalizimi i përmirësimit të kodit të transmetimit ishte, një akt nënligjor shumë i rëndësishëm për mediet audiovizive. Erdhi pas një procesi diskutimi dhe konsultimi nëntëmujor me grupet e interesit, me ekspertë vendës e të huaj, ndër të cilët vlen të përmendim partnerë të AMA-s dhe aktorë të rëndësishëm, që punojnë në këtë fushë, me institucione publike, organizata joqeveritare, kryesisht me fokus mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, Urdhrin e Mjekut, Urdhrin e Farmacistit, Departamentin e Gazetarisë dhe Komunikimit në Universitetin e Tiranës.

Gjatë vitit 2017 janë realizuar shqyrtimet tematike për të vlerësuar përputhshmërinë me ligjin nr. 97/2013 dhe kodin e transmetimit të përmbajtjeve të transmetuara, si mbrojtja e fëmijëve, reklammat dhe komunikimet tregtare, evidentimi i gjuhës së urrejtjes e të diskriminimit.

Në lidhje me problematikat e konstatuara, AMA u ka tërhequr vëmendjen subjekteve nën monitorim për respektimin e kuadrit ligjor. Gjithashtu, është sjellë në fokus respektimi i standardit të shqipes së folur e të shkruar në programet audiovizive.

Nga përmbajtjet e emetuara gjatë vitit 2017, konsiderohen me prioritet komunikimet tregtare, duke monitoruar e analizuar rastet e shkeljeve ligjore, për të cilat janë informuar subjektet përkatëse. Janë zhvilluar takime konsultative, informative dhe ndërgjegjësuere për respektimin e ligjit dhe kodin e transmetimit.

Një tjetër dokument shumë i rëndësishëm i Autoritetit të Medieve është buletini informativ me periodiciteti gjashtëmujor, që konsiderohet një objektiv i arritur. Në të paraqiten një sërë treguesish të tregut audioviziv, që prekin aspekte të ndryshme të këtij tregu, duke filluar nga financat, teknologjia, burimet njerëzore të angazhuara, përmbajtjet e transmetuara, volumi i reklamave, pronësia e të tjera.

Marrja e të dhënave për pranimet dhe largimet nga redaksitë audiovizive, niveli i pagave, kushtet e përgjithshme të punës kanë nxjerrë në pah edhe problematikat e rregullimit të marrëdhënies së punës, raportit me

punëdhënësit e punëmarrësit, formatet e kontratave që përdoren e të tjera.

Këto aspekte mjaft të ndjeshme për komunitetin e gazetarëve, AMA ka vijuar t'i trajtojë edhe në bashkëpunim me Komisionin Parlamentar për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, proces i cili është në vazhdimësi.

Gjatë vitit 2017 numri i ankesave dhe i çështjeve të trajtuara nga Këshilli i Ankesave u dyfishua në krahasim me 2016-ën, duke shënuar një trend në rritje për ndërgjegjësimin qytetar, por dhe rritje të besueshmërisë tek institucioni.

Pjesa më e madhe e ankesave kishin si tematikë kryesore rastet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, konkretisht cenimin e privatësisë, shkeljen e dinjitetit e të rregullave etike.

Një nga objektivat e AMA-s është edhe nxitja e një komunikimi sa më të thjeshtë dhe efikas me publikun, thjeshtëzimi i procedurave për kryerjen e ankesave e më pas shqyrtimi i tyre u reflektua në miratimin e rregullores për procedurat për trajtimin e ankesave dhe të drejtën e përgjigjes.

Gjithashtu, AMA është fokusuar te dukuria e piraterisë televizive. Vihet re një fenomen. Në qoftë se në piraterinë tradicionale, nëpërmjet operatorëve kabllorë, ka shumë përmirësim, kjo pirateri është duke u zhvendosur në rrjetet online. Këtu jemi duke bashkëpunuar shumë me aktorët e tregut, e patjetër me institucionet shtetërore, kryesisht AKEP-in.

Formalizimi i aktivitetit të tregut audio, pra radiove, vitin e kaluar solli përfundimisht lirimin e brezit frekuencor nga transmetimet e paligjshme audio. Kjo ishte problematike që prej fillimit të radiove të para private. Sot mund të themi me siguri se nuk ka asnjë radio që transmeton në mënyrë të paligjshme.

Gjatë periudhës raportuese, në zbatim të detyrimit të parashikuar të ligjit nr. 97/2013, Autoriteti ka përfunduar procesin e lëshimit të licencave për shërbimet audio të komunitetit, shërbim i cili synon promovimin e nevojave të komuniteteve të caktuara.

Një nga efektet kryesore të pritshme në tregun audio është rregullimi i aktivitetit të radiove me përmbajtje fetare. Në zbatim të rregullores përkatëse, në vitin 2017 AMA ka licencuar katër radiot e komuniteteve zyrtare, të njohura nga ligji, si: Radio Spectrum e

Komunitetit Mysliman; Radio Maria e komunitetit katolik; Radio Ngjallja e komunitetit ortodoks dhe Radio Dodona e komunitetit bektashian. Me shqyrtimet tematike të herëpashershme, Autoriteti është duke monitoruar edhe radio që kanë marrë licencë për të emetuar përmbajtje gjeneraliste, por që mund të kenë qasje ndaj një besimi të caktuar, duke kërkuar prej tyre respektimin e legjislacionit audioviziv, për qëndrime të paanshme në programet e tyre. Dy operatorëve, të cilët nuk e ndryshuan strukturën programore në përputhje me kushtet e licencës, nuk iu bë i mundur rinovimi i licencës.

Autoriteti i Medieve Audiovizive ka ndërmarrë disa iniciativa për të rritur bashkëpunimin me institucione të tjera publike, si Autoritetin e Konkurrencës, Ministrinë e Kulturës, Komisionin për Mbrojtjen e Konsumatorëve, Drejtorinë e Përgjithshme e Tatimeve, Ministrinë e Brendshme, prokurorinë, Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

Iniciativa për lidhjen e një marrëveshjeje bashkëpunimi midis institucioneve vjen gjithashtu në vijim të kërkesës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, për krijimin e hapësirave dhe thellimin e formave të bashkëpunimit midis organeve të krijuara me ligj, sikurse janë institucionet tona. Mbështetur në sa më sipër është propozuar nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit.

Rezultat i partneritetit tashmë të konsoliduar mes AMA-s dhe Departamentit të Gazetarisë dhe Komunikimit në Universitetin e Tiranës ishte dhe realizimi i studimit “Krizat e medieve televizive shqiptare dhe nevoja për një model të ri ekonomik”, që u përvijua edhe me zhvillimin në muajin dhjetor të konferencës shkencore “Modelet ekonomike të industrisë televizive në Shqipëri”. Objekt ishte performanca e operatorëve audiovizivë, për të evidentuar elemente të rëndësishme, që lidhen me modelin menaxherial, tregun e reklamave, pronësinë dhe bashkëpronësinë në aktivitetin audioviziv, ndikimi në përmbajtjet e emetuara etj. Në këtë proces u angazhuan 25 pedagogë dhe kërkues shkencorë, si dhe një numër shumë i madh studentësh.

Gjatë vitit 2017, në bashkëpunim edhe me subjekte që janë të angazhuara në fushën e

medies ose në fushën e të drejtave të njeriut, për kualifikime të redaksive audiovizive, nga projektet kualifikuese përfituan rreth 160 gazetarë, redaktorë dhe reporterë terreni në fushën e medieve audiovizive, kryesisht në qarqet: Tiranë, Shkodër, Lezhë, Vlorë dhe Elbasan.

Përmirësimi i treguesve financiarë të veprimtarisë së Autoritetit, si dhe rritja e efektivitetit të përdorimit të këtyre burimeve kanë qenë objektivat kryesorë për vitin 2017. Kështu që, falë burimeve të saj të financimit, AMA ndërmori investime dhe shpenzime të rëndësishme, ku vlen të përmendet ndërtimi i një objekti të ri funksional dhe me standarde bashkëkohore.

Institucioni i AMA-s dhe veprimtaria e disa viteve më parë cilësohej në progresraportet e Komisionit European si institucion i bllokuar, me mungesë të theksuar vendimmarrjeje për shkak të kuorimit të anëtarëve të bordit. Aktualisht, referuar progresraportit të këtij Komisioni, evidentohet kthimi në normalitet i këtij aktiviteti.

I nderuar Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, këto ishin disa nga aspektet kryesore të këtij prezantimi. Materiale më të thelluara mund t'i gjeni në dokumentin e dorëzuar në Komisionin e Medies, si dhe në faqen *online* të Autoritetit.

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Sala!

Pyetje nuk ka, kërkesë për debat nuk ka, atëherë ngelet rezoluta për t'u votuar.

Urdhëroni!

Sali Berisha – Si mund të dalë dhe të flasë në parlament ky zotëri, ky vasal, në një kohë kur ka shkuar aty në konflikt të plotë interesi, ka shkuar si vasal i konfliktit të interesit, ka shkuar dhe ka pjellë ERTV-në dhe nuk flet një fjalë?! Çfarë pune ka ky të dalë para parlamentit?! A nuk është kjo një fyerje për parlamentin?! E morët nga “Top Channel” dhe i dhatë AMA-n!

(Reagim pa mikrofon)

Po, po. Ku punonte më parë ky zotëri, Pandeli, pa më thuaj pak? Jo, ma thuaj, apo konflikti i interesit nuk ekziston për ju?! E keni shndërruar konfliktin e interesit në parim udhëheqës, në një kohë që është shtyllë kryesore e korrupsionit! Si ndihet kur del këtu në parlament?! Të paktën mos e sillni këtu, mbajeni atje dhe bëni çfarë të doni me valët! Ato medie i

menderosni çdo ditë. Ndaj këtij rëndojnë krime të rënda në fushatat zgjedhore. Asnjë masë nuk ka marrë për shkeljet monstruoze të medie gjatë fushatës zgjedhore. Asnjë masë nuk merr për neverinë që krijon Kryeministri i tij nga mëngjesi deri në darkë, duke tejkaluar edhe liderin e Venezuelës dhe çdo lider tjetër. Llomotit nga mëngjesi deri në darkë në medie dhe ky institucion është shndërruar në vasal të tij. Për çfarë arsye i nxjerr këtu këta?! Për çfarë arsye vijnë këtu, apo për t'u shpëlarë? Këta janë simbole të korrupsionit të një regjimi, i cili po e largon Shqipërinë çdo ditë nga Europa. Zotëri, nuk duhej të vinte këtu; nuk ka asnjë të drejtë të vijë këtu.

Gramoz Ruçi – Zoti Berisha, këtu kemi të bëjmë me një raport vjetor...

Sali Berisha – Çfarë zoti Berisha?!

Gramoz Ruçi – ...të veprimtarisë së Autoritetit të Medieve Audiovizive. Ai është kryetari i këtij Autoriteti.

(Zoti Berisha flet pa mikrofon.)

Kështu që është kryetar i zgjedhur nga ky parlament.

(Zoti Berisha flet pa mikrofon.)

Keni pyetje, zoti Balla?

Taulant Balla – Për procedurë, zoti Kryetar.

Gramoz Ruçi – Ju lutem, a ka njeri tjetër pyetje? Nuk ka pyetje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Urdhëroni, për procedurë!

Edmond Spaho – Zoti Kryetar, ashtu siç e dini, kemi hyrë një fazë kritike: vendi pret hapjen e negociatave me Bashkimin Europian. Në fund të muajit qershor është mbledhja e Këshillit të Ministrave, i cili do të vendosë nëse Shqipërisë do t'i jepet apo jo data për hapjen e negociatave. Por, sikurse jeni në dijeni, gjatë gjithë kësaj periudhe vendet anëtare të BE-së, veçanërisht vendet kryesore, kanë paraqitur një sërë rezervash ndaj Shqipërisë, veçanërisht në drejtim të luftës ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit, duke filluar nga Presidenti i Parlamentit Europian, nga Presidenti i Këshillit Ekzekutiv dhe nga vende të tilla, si: Gjermania, Holanda dhe Franca. Gjatë ditëve të fundit edhe kryetari i Partive Popullore Europiane theksoi se Shqipërisë nuk do t'i hapen negociatat, nuk do t'i jepet datë, nëse nuk do të bëjë më shumë në drejtim të krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Më saktësisht, e kishte fjalën nëse nuk do të largohet ministri i Brendshëm, zoti Fatmir Xhafaj.

Të njëjtën histori keni pasur edhe me ish-ministrin e Brendshëm, Saimir Tahirin. Tani po e futni vendin në qerthull për shkak të emërimit të njëpasnjëshëm të ministrave, të cilët janë lidhur me botën e krimit. Nuk është e nevojshme t'ju kujtoj që ministri aktual ka vëllanë të dënuar për krijimin e organizatave kriminale dhe për trafik ndërkombëtar droge.

Në asnjë vend tjetër të Bashkimit Europian dhe me gjerë në të gjithë Europën nuk gjen një precedent të tillë, pra që ministri, i cili supozohet se do të luftojë krimin e organizuar dhe drogën, ta ketë vëllanë të dënuar për krijimin e organizatave kriminale dhe për trafik ndërkombëtar droge.

Ju e dini qëndrimin e opozitës prej kohësh, por do të dëshironim, për shkak të rëndësisë shumë të madhe që ka hapja e negociatave, të diskutonim me ministrin e Brendshëm dhe me Kryeministrin. Për fat të keq, asnjëri prej tyre nuk është sot në seancë. Do të dëshironim që ju të ndërhynit dhe të siguronit pjesëmarrjen e ministrit të Brendshëm dhe të Kryeministrit në seancë.

Gramoz Ruçi – Faleminderit!

Zoti Balla, për procedurë.

Taulant Balla – Zoti Kryetar,

Para pak minutash drejtuesi i një institucioni të pavarur, i zgjedhur me votën e këtij Kuvendi, u sulmua në mënyrë të pandershme nga një deputet, i cili lëshoi pa të drejtë akuza ndaj një institucioni të pavarur, për të cilin është ndjekur parimi i balancimit të përfaqësimit politik, po të kemi parasysh faktin që institucioni, i cili referon sot punën njëvjeçare në Kuvendin e Shqipërisë, ka edhe përfaqësues të propozuar nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, sipas ligjit "Për funksionimin e Autoritetit të Medieve Audiovizive në Republikën e Shqipërisë". Është e pandershme që një deputet të përdorë karrigen e deputetit dhe pozicionin e tij për të sulmuar në mënyrë të pandershme një institucion të pavarur. Ndërkohë, janë të gjitha modalitetet që secili prej deputetëve në rezolutën që bashkëshoqëron vlerësimin e punës njëvjeçare, të mund të kishte paraqitur vlerësimin, por duhet të kemi parasysh që vlerësimi është për institucionin, nuk është

për personin dhe asnjë përfaqësues i organeve të pavarura nuk mund të intimidohet nga një deputet, i cili, kur vjen puna për respektimin e parimeve të transmetimit audioviziv, është thyerësi numër 1 i rregullave për funksionimin e transmetimit në këtë sallë, kur ekskluziviteti i transmetimit rregullohet sipas procedurave ligjore.

Së dyti, lidhur me kërkesën e kryetarit të Grupit Parlamentar të PD-së, ju lutem, duhet të jeni korrektë kur citoni përfaqësues të nderuar të institucioneve europiane. E kam fjalën për Kryetarin e Parlamentit Europian, mikun e të gjithëve, e të majtëve dhe të djathtëve, Antonio Tajani, i cili nuk e ka thënë kurrë këtë që ju po citoni. Tajani është një ndër mbështetësit kryesorë të hapjes së menjëhershme dhe pa asnjë kusht të negociatave me Shqipërinë, sikurse dy grupet, ai i Socialdemokratëve dhe ai i Partive Popullore Europiane, të cilat tashmë kanë një qëndrim shumë të saktë për këtë çështje.

Ndërkohë, përfitoj nga rasti, si kryetar i Grupit Parlamentar të PS-së, t'i ripërsëris Grupit Parlamentar të PD-së dhe atij të LSI-së që betejën e përbashkët, në interes të Shqipërisë, për të lobuar për hapjen e negociatave mund ta zhvillojmë së bashku, pavarësisht se jeni shumë vonë. Pavarësisht përpjekjeve në fillimin e kësaj jave të kryetarit të opozitës për të qenë fshehurazi në korridoret e Bundestagut gjerman, jam shumë i sigurt se brenda Bundestagut gjerman kemi mbështetjen e nevojshme për ta vijuar këtë proces në funksion të 28 qershorit, por edhe pas 28 qershorit.

Faleminderit!

(Reagim pa mikrofon)

Gramoz Ruçi – Ju lutem! Zoti Spaho, çfarë keni?

(Reagim pa mikrofon)

Fjalën e ka zoti Basha për replikë.

Lulzim Basha – Të dashur qytetarë,

Në këtë seancë gjeni shprehjen më të qartë të kapitullimit dhe të rënies së qeverisë së krimit dhe të drogës, ku mungojnë dy nga kokat kryesore të aleancës së pushtetit me krimin, Edi Rama dhe Fatmir Xhafaj.

Kërkesa e kryetarit të Grupit Parlamentar të PD-së është e qartë dhe e kuptueshme për ju, si Kryetar i Kuvendit, për deputetët, për median dhe për çdo qytetar: kjo seancë nuk mundet dhe nuk duhet të vazhdojë pa praninë e atyre të dyve

këtu. Llogaridhënia e tyre në këtë moment kyç dhe kritik për të nesërmen, për vendimmarrjen europiane është një detyrim moral dhe politik. Në qoftë se kanë vendosur të mos vijnë më në këtë sallë, atëherë le ta çojnë deri në fund: të largohen sot e ta çlirojnë Shqipërinë nga aleanca e krimit me pushtetin, që është pengesa nr. 1 për integrimin europian të vendit. Këtë shqetësim ia kanë shprehur fare qartë ditën e martë përfaqësuesit më të lartë gjermanë përfaqësueses së Partisë Socialiste gjatë vizitës së saj në Bundestag. Natyrisht, më kanë informuar edhe mua, pra jam informuar hollësisht për qëndrimin e Bundestagut, të Kancelarisë, të Elizesë, të Binenofit, të Bartenhofit dhe të kancelarive të tjera europiane, madje shumë më mirë se disa prej jush këtu. Natyrisht, të paimformuar nuk janë as ata të dy që mungojnë. Ata e dinë fare mirë se çfarë duhet të bëjnë. Ai duhet të largohet një orë e më parë dhe ky tjetri duhet të marrë përgjegjësitë...

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Basha!

(Reagim pa mikrofon)

Ju lutem, tani!

(Reagim pa mikrofon)

Jo, kërkohet ose për replikë, ose për procedurë.

(Reagim pa mikrofon)

Çfarë ke që bërtet?! Le të jetë! Zotëri, mos u ngri në këmbë dhe mos e ngri zërin! E kërkoj fjalën për replikë, ia dhashë.

(Reagim pa mikrofon)

Si deri nesër?

Vazhdoni edhe tri minuta për procedurë!

Lulzim Basha – Do përkthim, doktor! Do përkthim filibaster, se nuk e kuptojnë. Do përkthim politik.

Çështja është fare e thjeshtë: ka 4 javë që skandali i vëllezërve Xhafaj, njëri kokë e krimit të organizuar në Vlorë dhe në mbarë Shqipërinë, tjetri ministër i Brendshëm, i cili e mbron e i mundëson aktivitetin kriminal, ka pushtuar vëmendjen e opinionit publik, natyrisht edhe të partnerëve tanë ndërkombëtarë; ka 4 javë që Edi Rama dhe Fatmir Xhafaj i fshihen së vërtetës; ka 4 javë që kjo sallë, institucionet e këtij vendi, kjo parti politike po mbahen peng për të mbrojtur Agron Xhafajn dhe Fatmir Xhafajn. I mban peng Edi Rama!

E vërteta është se këtë të hënë dhe këtë të martë isha në Berlin, jo në vizitë klandestine, siç

bëni ju, as të paguar me milionat e drogës, të kanabisit të diplomacisë suaj, por i fuar nga autoritetet më të larta gjermane për të diskutuar shqetësimin e tyre se situata politike në vend, 6 javë pas largimit të Edi Ramës nga Berlini, jo vetëm që s'ka shkuar drejt përmirësimit, por ka shkuar drejt përkeqësimit, se Saimir Tahiri, ashtu siç paralajmëruam, u lirua si pjesë e paktit mafioz Rama-Tahiri. E njëjta skemë po ndiqet për të mbrojtur vëllezërit Xhafaj. Në këto kushte është e paimagjinueshme që Bundestagu apo cilido institucion tjetër evropian të rekomandojë atë që keni kërkuar ju dhe ne: hapjen e negociatave, ju me pretendimin se Shqipëria e meriton për shkak të reformave që keni bërë dhe ne me fakte dhe argumente që, në vend që të shkoni përpara, keni shkuar mbrapa në raport me demokracinë, me shtetin ligjor, luftën kundër krimit, luftën kundër korrupsionit. Hapja e negociatave është instrumenti i vetëm, i cili mund të garantojë presion maksimal ndaj bandës që qeveris sot këtë vend pa ligj dhe pa Kushtetutë.

Edhe një herë, zoti Kryetar, pezullo seancën, thirr këtu Edi Ramën dhe Fatmir Xhafajn dhe deri në momentin që ta...

(Lulzim Basha flet pa mikrofon)

Gramoz Ruçi – Zoti Basha, parlamenti nuk ka instrumente të tjera, kërkesën tuaj kërkojeni në një seancë pyetjesh, interpelance ose mocion me debat me Kryeministrin dhe menjëherë do të planifikohet.

Për sa u përket interpretimeve lidhur me merakun e hapjes së negociatave, ju duhet të kontribuoni vërtet për hapjen e negociatave dhe të mos flisni në emër të kancelarive të ndryshme europiane, aq më tepër kur ato nuk i keni të sakta, sepse ju flisni në emër të Gjermanisë, por, në dijeninë time, dje qeveria gjermane ka vendosur të mbështesë hapjen e negociatave për Shqipërinë. Kështu që, ju lutem shumë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, zoti Basha, lironi foltoren, me qëllim që të marrë fjalën institucioni tjetër i radhës! Bëni kërkesë me shkrim dhe unë do ta planifikoj siç janë rregullat! Nëse do të vazhdoni skenarin tuaj për të krijuar anomali dhe për të marrë peng sallën e Kuvendit, po ju them se nuk keni për ta realizuar, maksimumi do të shtyni edhe një javë mosraportimin e tri institucioneve të rëndësishme, atë të veprimtarisë së Autoritetit

për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, të Radiotelevizionit Shqiptar dhe për Prokurimet Publike, por seanca do të vazhdojë. Prandaj, ju lutem, edhe njëherë, zoti Basha, jepni kontributin tuaj, si lider i opozitës, për të mos marrë peng sallën e parlamentit! Ju thashë ta institucionalizoni kërkesën tuaj sipas Rregullores, për një seancë pyetjesh, seancë interpelance, apo mocion me debat dhe, sigurisht, unë do t'i vendos në axhendën e Kuvendit nëpërmjet Konferencës së Kryetarëve dhe seancës së parlamentit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Berisha, meqë po ndërhysh nga vendi, këtu ke të regjistruar 25 orë diskutim vetëm nga opozita, prandaj i lini vetes mundësinë që të diskutoni 25 orë, sipas kërkesës suaj. Me marrjen peng, pezulloni edhe fjalën e opozitës.

Ju lutem, zoti Basha, depozitoheni me shkrim dhe unë do ta vendos menjëherë në axhendën e parlamentit! Sot nuk kemi asnjëherë e as tjetër, sot kemi për të dëgjuar këto institucione, që ju thashë dhe projektligjet. Nëse do të ketë probleme me projektligjet, sigurisht që do të jenë edhe ata prezent në sallë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, uluni! Unë nuk kam pse ta ndërpres seancën, sepse kërkesa jote është në kundërshtim me Rregulloren e parlamentit, kështu që institucionalizojë atë! Rregullorja, me të gjithë përpjekjet tuaja për ta asgjësuar, do të veprojë, i nderuar lider i opozitës. Ju lutem, duke qenë se jeni lider i opozitës, mendohuni se Rregullorja e Kuvendit duhet zbatuar gjithmonë, me qëllim që të ketë normalitet në Kuvend. Nëse ti do të japësh mesazhin se nuk ka normalitet në Kuvendin e Shqipërisë, sigurisht që ata që na gjykojnë, më gjykojnë edhe mua, si drejtues i seancës, maxhorancën dhe opozitën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Absolutisht, Kushtetuta thotë: "Institucionet kushtetuese dhe ato të pavarura duhet të raportojnë një herë në vit në parlament". Ju po e privoni Kuvendin nga e drejta e zbatimit të Kushtetutës, jeni në shkelje të plotë të Kushtetutës dhe të ligjeve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bëj mocion për t'i shkarkuar, zoti Berisha! Ke 50 orë diskutim këtu dhe do të jemi ditë dhe natë këtu që t'ju dëgjojmë.

Ju lutem, zoti Basha!

Ndërpritet seanca.
10 minuta pushim.

(Rifillon seanca)

Gramoz Ruçi – Media të futet brenda!

Rifillojmë seancën e parlamentit me raportin...

(Diskutime nga salla pa mikrofon)

Për procedurë?

Zoti Basha ka kërkuar fjalën për procedurë.

Lulzim Basha – Zoti Ruçi, e shoh që keni dështuar në përpjekjen tuaj për të sjellë në këtë sallë dy personazhet kryesore të skenarit kriminal për mbrojtjen dhe pandëshkueshmërinë e ish-ministrit të Brendshëm, yllit 4-vjeçar të Edi Ramës, Saimir Tahiri, dhe për mbrojtjen e klanit mafioz të vëllezërve Xhafaj.

Pyetja që shtrohet është: çfarë kanë të përbashkët këta të dy që nuk vijnë sot në parlament që të përballen me opozitën, të përballen me qytetarët shqiptarë, të përballen me medien?

Përgjigjen për këtë na e kanë borxh ata. Në qoftë se refuzojnë të vijnë në këtë seancë, jemi gati t'ju japim me fakte dhe prova të padiskutueshme se çfarë gjëje më të rëndësishme ka Edi Rama dhe Fatmir Xhafaj tani që nuk i lejon të vijnë në këtë sallë, që nuk e lejon Kryeministrin të mbledhë qeverinë ose të qeverisë. Ata të dy dhe pjesa më e madhe e kësaj qeverie të gangrenizuar nga krimi dhe lidhjet me trafiket e drogës janë të detyruar të shpenzojnë gjithë ditën dhe natën e tyre në skenarë kriminalë të shkatërrimit dhe të fshehjes së provave për hetimet ndaj Saimir Tahirit, për hetimet që duhet të zhvillohen ndaj Agron, Geron dhe Fatmir Xhafajt dhe, natyrisht, për hetimin që duhet të kishte nisur një prokurori, në qoftë se do t'i kishte mbetur një fije pavarësie, ndaj Edi Ramës, si pjesëmarrës në një skenar kriminal, në kuptimin penal të fjalës, jo në kuptimin politik; për të zhdukur dhe shkatërruar provat, për të penguar drejtësinë në hetimin e Agron Xhafajt, një prej kokave të drogës dhe krimit të organizuar në Vlorë dhe në mbarë Shqipërinë.

Ndaj edhe një herë, duke mirëkuptuar pafuqinë tuaj, u bëj thirrje Edi Ramës dhe Fatmir

Xhafajt të dalin nga vrimat ku janë strukur, të vijnë këtu dhe të përballen me të vërtetat ose t'i japin fund makthit të tyre, duke dhënë edhe formalisht dorëheqjen, sepse praktikisht janë dorëhequr nga çdo detyrë kushtetuese dhe ligjore. E vetmja detyrë që kryejnë nga mëngjesi deri në darkë është mbrojtja e krimit dhe e aferave kriminale ku janë zhytur e po zhyten dita-ditës.

Thërrit Edi Ramën, Fatmir Xhafajn të përballen me opozitën, të përballen me të vërtetën...

Gramoz Ruçi – Zoti Basha, fuqia apo pafuqia e drejtuesit të Kuvendit është Kushtetuta, është ligji, është Rregullorja...

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Jo, nuk e marr fare personale!

Në zbatim të Kushtetutës, të ligjit dhe të Rregullores, Kryetari i Kuvendit ka detyrimin t'u sigurojë institucioneve kushtetuese dhe ligjore të ngritura me ligj që sot t'i raportojnë Kuvendit dhe nëpërmjet tij qytetarëve të Shqipërisë për institucionet që ata përfaqësojnë.

Uzurpimi i foltres nga ana juaj bën që kjo kërkesë e Kushtetutës, e ligjit dhe e Rregullores të mos zbatohet. Nëse ju e quani pafuqi timen heqjen tuaj me forcë nga foltorja e parlamentit, Kuvendi nuk është vendi i mundjes, nuk është vendi i forcës, është vendi i zbatimit të Kushtetutës, është vendi i zbatimit të ligjit, është vendi i zbatimit të Rregullores, i etikës parlamentare, i normave të demokracisë.

Ju lutem, lejojini këto institucione të informojnë Kuvendin e Shqipërisë, me qëllim që të zbatohet Kushtetuta, ligji dhe Rregullorja.

Për sa i përket çështjes tjetër që ngritët, po jua sqaroj edhe një herë, Kryeministri, ministri dhe e gjithë qeveria vijnë në Kuvendin e Shqipërisë kur deputetë apo grupime politike kanë kërkuar një seancë pyetjesh, një seancë interpelance, një mocion me debat apo një mocion mosbesimi e të tjera, gjë që ju nuk e keni bërë. Ju garantoj se, në qoftë se ju do ta bëni, do ta mbledh menjëherë Konferencën e Kryetarëve dhe menjëherë do të futet në axhendën e Kuvendit, me qëllim që ju si opozitë të ballafaqoheni me ekzekutivin e shtetit shqiptar.

Aktualisht të dy titullarët, si Kryeministri, edhe ministri i Brendshëm janë në krye të punëve të tyre, duke bashkëbiseduar me aktorë dhe faktorë ndërkombëtarë, sipas axhendës që

kanë. Në momentin e duhur ata do të jenë prezentë në sallën e parlamentit për të ushtruar funksionet ekzekutive dhe detyrat e tyre si anëtarë të Kuvendit, për të diskutuar dhe për të miratuar ligjet që pasojnë pas raportimit të institucioneve kushtetuese.

Ju lutem edhe një herë, lironi foltoren, që drejtuesit e këtyre institucioneve të kenë mundësi të marrin fjalën për të përmbushur detyrimin kushtetues dhe ligjor që ata kanë për të raportuar para Kuvendit të Shqipërisë, pasi unë nuk kam mekanizëm tjetër, Kuvendi s'ka një vend tjetër, ku këto institucione mund ta ushtrorjnë funksionin e tyre për të dhënë llogari para Kuvendit.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Për procedurë fjala jepet vetëm një herë. Unë ia kam dhënë fjalën dy herë.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Në qoftë se do ta rimerrni fjalën për procedurë, me angazhimin për të liruar foltoren, jam plotësisht dakord.

Keni 3 minuta kohë në dispozicion.

Lulzim Basha - Zoti Ruçi, ju flisni për një realitet që ekziston vetëm në kokën tuaj!

As në këtë sallë, as në këtë vend, në asnjë qytet dhe në asnjë fshat nuk vepron më as ligji, as Kushtetuta. Këtu në këtë sallë më 16 dhjetor e keni "therur" Kushtetutën, keni dhunuar reformën në drejtësi, për të vënë në krye të Prokurorisë së Përgjithshme kukullën tuaj, e cila do të garantonte atë që po ndodh: lirimin e Saimir Tahirit, shkatërrimin e hetimeve, provave, ekstradimin e paligjshëm të dëshmitarëve të çështjes, bllokimin dhe mbrojtjen me çdo kusht të Agron Xhafajt dhe Fatmir Xhafajt, sepse kjo ishte e vetmja mënyrë se si mund të mbrohej kreu i kësaj pune, kreu i kësaj kupole, Edi Rama.

Ju flisni për ligjin, ndërkohë që Florin Onuzin, babanë e tre fëmijëve, që s'ka asnjë lekë për t'i mbështetur, për t'u blerë bukën e jo më për të blerë librat dhe këpucët për t'i çuar në shkollë, e latë të pësonte atak kardiak në qelitë e burgut, sepse u ngrit kundër trarit që i vutë te dera e shtëpisë. Saimir Tahiri pi birra në ballkon, në ish-Blllok, me kapot e drogës dhe krimit të përfshirë këtu edhe vëllain e Kryeministrit.

Katër të tjerë i mbani ende në qeli, me qindra shqiptarë i mbani në qeli, shpeshherë në shkelje flagrante të ligjit, ku të drejtat e tyre kushtetuese shkelen mizorisht nga një tufë

horrash, të maskuar nën uniformën e Policisë së Shtetit, që po turpërojnë gjithë atë trupë njerëzish, të cilët duhet t'i shërbejnë ligjit, por sot kanë vetëm një qëllim: t'u shërbejnë makthit dhe anktheve të Edi Ramës, Fatmir Xhafajt dhe Saimir Tahirit.

Ndaj, siç e kuptoni, nuk jeni në pozicion të negocioni me mua për zbatimin e Rregullores, kur ju jeni bashkëpërgjegjës për dhunimin e Kushtetutës dhe të ligjit!

Edi Rama dhe Fatmir Xhafaj tani nuk kanë asnjë punë të rëndësishme, përveçse të shpëtojnë lëkurën e tyre, mision ky krejtësisht i pamundur. Dëgjojeni mirë! Mision i pamundur! Kësaj radhe, proçka që keni bërë ka marrë erë dhe nuk ka lobist dhe miliona droge t'i vënë...

(Mungesë audio)

Gramoz Ruçi - Ju lutem, uluni, zoti Basha!

(Diskutim pa mikrofon)

Zoti Basha, koha juaj ka mbaruar!

(Diskutim pa mikrofon)

Ju lutem, uluni! Keni regjistruar emrin për të diskutuar për tri projektligjet në vijim, ku do të keni në dispozicion 50 minuta.

(Diskutim pa mikrofon)

Mos ia privoni këtë të drejtë vetes, që jua siguron Rregullorja e Kuvendit për të folur 50 minuta, zoti Basha!

Bashkë me ju, grupi juaj parlamentar do të ketë në dispozicion mbi 30 orë për të diskutuar.

(Diskutim pa mikrofon)

Zoti Basha... Thërrisni Kryeministrin apo ministrin në një interpelancë a mocion dhe flisni gjithë ditën!

Uluni, zoti Basha, të dëgjojmë këto tri institucione dhe pastaj mund të vazhdosh të flasësh! I pari që do të marrë fjalën do të jeni ju!

(Diskutim pa mikrofon)

Zoti Basha, mund të flisni me mikrofon! Do t'jua jap fjalën të parit, sepse jeni regjistruar i pari!

(Diskutim pa mikrofon)

Do t'ia jap fjalën kur të diskutohet ligji!

(Diskutim pa mikrofon)

Ndërpritet edhe një herë seanca!

(Rifillon seanca)

Gramoz Ruçi - Të futen mediet brenda!

Rifillojmë seancën!

Fjalën për procedurë e ka ministrja e Shëndetësisë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, e ka kërkuar fjalën zonja!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju thashë, e ka kërkuar fjalën zonja ministre.

Ogerta Manastirliu – Të nderuar deputetë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale prej datës 4 qershor ka nisur fushatën e dhurimit të gjakut, që është një ndër fushatat më të rëndësishme në ndihmë të fëmijëve talasemikë. Deri më sot na janë bashkuar 219 dhurues vullnetarë gjaku.

Sot Banka Kombëtare e Gjakut është në ambientet e Kuvendit të Shqipërisë dhe unë do t'ju kërkoja në emër të fëmijëve talasemikë, por edhe në emër të përgjegjësive sociale të secilit prej nesh, si një akt solidariteti, të bashkohemi të gjithë deputetët për të dhuruar gjak në ndihmë të fëmijëve talasemikë.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gramoz Ruçi – Ju lutem, të dëgjojmë!

Zoti Basha,

Është hera e tretë që e kërkon fjalën për procedurë. Duhet të dini që për një çështje merret vetëm një herë fjala për procedurë, ndërsa ju e keni marrë tri herë.

E dyta, dy herët e mëparshme e keni shpërdoruar kohën e kërkuar për procedurë, pasi problemet që ju trajtuat, nuk kishin të bënin me çështje të procedurës.

Shpresoj që kësaj radhe do t'i përmbaheni nenit 49 të Rregullores, që thotë se problemet e procedurës janë çështje që kanë të bëjnë me zbatimin e Rregullores, me plotësimin e rendit të ditës, me ndërprerjen e diskutimit apo me mënyrën e marrjes së vendimit apo të votimit.

Kështu, po jua jap edhe një herë fjalën, por ju lutem, mos e shpërdoroni foltoren e parlamentit, me qëllim që të vazhdojmë me raportimin normal të institucioneve që kemi në rendin e ditës!

Keni 3 minuta, zoti Basha.

Lulzim Basha – Zoti Ruçi,

Ndërkohë që Edi Rama dhe Fatmir Xhafaj vazhdojnë të fshihen vrimave të miut për të mos u përballur me të vërtetën, ndërkohë që ata po bëjnë gjithçka për të mos u përballur me të vetmen aulë, ku dëgjohet zëri i opozitës, pa filtrat e medias së kapur dhe të analistëve të blerë me paratë e drogës, vazhdon avazi i nisur prej 3-4 ditësh i qeverisë “bamirëse”.

Edi Rama u hoqi ndihmën ekonomike 30 mijë familjeve dhe i hodhi në mes të katër rrugëve dhe para dy ditësh na u ul në një mexhllis të stisur, gjoja për bamirësi. Natyrisht, këto gjëra të shëmtuara ndodhin në 2 lloj vendesh: në vendet, ku injoranca sundon mjerimin e varfërinë dhe në territoret e mafies.

Bamirësia e stisur, e shtirur është një ndër aktet e mafies për përmirësimin e imazhit; paradoksi i njeriut, që u hoqi bukën 30 mijë familjeve, qindra prej të cilëve i kam vizituar personalisht.

Ciniku, i cili bënte sikur nuk i shihte baballarët që shisnin gjakun e trupit për të ushqyer fëmijët, jetimët, papritur na holloi zërin, na përkundi shtatin dhe na mori pozat e Nënë Terezës. Kjo është një gjë e shëmtuar që duhet dënuar me forcë nga çdo shoqëri e emancipuar, nga çdo njeri me ndërgjegje qytetare dhe patriotike, qoftë me tetëvjeçare, me shkollë të mesme e në veçanti nga ata pak intelektualë të pavarur që i kanë mbetur vendit.

Sa për talasemikët e sapopërmendur këtu, do të mjaftonte një e dhjeta e parave që kanë shpërdoruar dhe kanë vjedhur Edi Rama, Arben Ahmetaj dhe Damian Gjiknuri për t'u kujdesur për tri gjeneratat e talasemikëve në të gjithë Mesdheun.

(Bie gongu.)

Ndaj, lërin këto poshtërsi, këto hipokrizi! Ky është poshtërim për talasemikët! Ky është poshtërim për të varfrit! Këtu ka një dhe vetëm një problem: shteti është kapur nga krimi. Ndaj, thirri të vijnë këtu, që të përballen me të vërtetat dhe faktet!

(Deputeti Balla flet nga vendi pa mikrofon.)

Gramoz Ruçi – Uluni, zoti Basha!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Basha, po ta përsëris për të disatën herë, ti, si lider i opozitës, mund të përballesh me Kryeministrin vetëm nëpërmjet seancës së pyetjeve, seancës së interpelancave, seancës me mocion mosbesimi, seancës me mocion për

debat apo nëpërmjet debatit parlamentar. Ti po uzurpon foltoren e parlamentit vetëm në seancën e sotme për të tretën herë radhazi!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë e kuptoj se nëpërmjet foltores së parlamentit ju doni të tregoni se Shqipëria është në një situatë të jashtëzakonshme, por ne jemi në një situatë krejt të zakonshme. Ky është mesazhi që ju doni të përcillni, po përpiqeni shumë.

Më vjen keq...

(Deputeti Paloka flet nga vendi pa mikrofon.)

Më vjen keq që doni të përcillni këtë mesazh deri në datën 28.

Ju lutem, edhe një herë, sepse jo vetëm nuk i shërbeni vendit, por as rolit tuaj si opozitë me këtë formë. Prandaj, për të disatën herë po ju kërkoj: lironi foltoren, në mënyrë që të tria institucionet që kanë ngelur dhe janë parashikuar sot për të informuar Kuvendin dhe për të raportuar para tij të përmbushin detyrën e tyre kushtetuese dhe ligjore!

Kërkojeni dhe ballafaqohuni me të...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

Pasi të mbarojnë së raportuari institucionet kushtetuese, do të ketë një debat të gjerë, por kur flasim për debat, jo me monolog, por me radhë secila palë të shprehë opsionet e saj.

Ju lutem, zoti Basha, uluni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Basha, uluni!

Në qoftë se doni të vazhdoni skenarët e tri seancave të mëparshme, se ju erdhi koha, ju erdhi momenti, ju erdhi ora që të komunikoni nëpërmjet Facebook-ut, është puna juaj. Unë jam këtu për të drejtuar Kuvendin, jo rrjetet sociale, që janë në axhendën tuaj të punës!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk e lejon Rregullorja që të hapet mikrofon. Prandaj, ju lutem edhe një herë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kërkojeni sipas rregullave! Mos e humbisni shansin për të folur sot tërë ditën e tërë natën!

Zoti Basha, a mund të uleni, që ta marrin fjalën përfaqësuesit e tri institucioneve kushtetuese?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Uluni, zoti Basha!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, ndërpritet seanca për herë të tretë, dhjetë minuta.

(Rifillon seanca.)

Gramoz Ruçi - Uluni, kolegë deputetë!

Të futen mediet brenda.

Atëherë, rifillojmë seancën.

Zoti Basha, lironi foltoren, në mënyrë që të vazhdojmë seancën me raportimet!

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon.)

Nuk ka më për procedurë.

U kërkoj ndjesë të gjithë deputetëve, që kanë ardhur sot për të dëgjuar raportimet e tri institucioneve kushtetuese! I kërkoj ndjesë edhe publikut, që është i interesuar për të dëgjuar raportimet e këtyre institucioneve! Gjithashtu, u kërkoj ndjesë zonjës Gentiana Sula, zotit Kristaq Traja dhe zonjës Evis Shurdha, sepse nuk mund të raportojnë dhe raportimi i tyre do të shtyhet për seancën tjetër!

Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës, me projektligjin "Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës".

Për këtë projektligj nga Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste kanë regjistruar emrat deputetët: Taulant Balla, Erion Braçe, Elisa Spiropali, Blerina Gjylameti, Anastas Angjeli, Ervin Bushati, Vasilika Hysi, Mimi Kodheli, Evis Kushi, Klotilda Bushka, Antoneta Dhima, Andrea Marto, Sadi Vorpsi, Xhevit Bushaj, Arben Pëllumbi, Roland Xhelilaj dhe Milva Ekonomi.

Nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike kanë regjistruar emrat deputetët: Lulzim Basha, Sali Berisha, Edmond Spaho, Edi Paloka, Albana Vokshi, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Fatmir Mediu, Flamur Noka, Jorida Tabaku, Tritan Shehu, Ervin Salianji, Florjon Mima, Grida Shqina, Genc Pollo, Bardh Spahia, Aldo Bumçi, Dashamir Shehi, Dhurata Çupi, Endri Hasa Fartbardha Kadiu, Halim Kosova, Hekuran Hoxhalli, Isuf Çelaj, Izmira Ulqinaku, Klevis Balliu, Lindita Metaliaj, Lorenc Luka, Luan Baçi, Luçiano Boçi, Myslim Murri, Nadire Meçorapaj, Nard Ndoka, Orjola Pampuri, Romeo Gurakuqi, Rudina Hajdari, Valentina Duka, Vangjel Dule dhe Xhemal Gjunkshi.

Nga Grupi Parlamentar i partisë Lëvizja Socialiste për Integrim kanë regjistruar emrat deputetët: Luan Rama, Petrit Vasili, Monika Kryemadhi, Klajda Gjoshë, Edmond Panariti, Edmond Haxhinasto, Përparim Spahiu, Endrit Braimllari dhe Viktor Tushaj.

Fillojmë me diskutimet.

Fjala për diskutantin e parë nga grupi i opozitës, zotin Lulzim Basha.

Lulzim Basha – Zonja dhe zotërinj,

Të dashur qytetarë,

U mbushën plotë katër javë e disa ditë që nga publikimi i fakteve se vëllai i ministrit të Brendshëm, i dënuar për trafik droge, jo vetëm mbrohej, por i sigurohej liria dhe të gjitha kushtet, me mbështetje policore, politike dhe qeveritare, për të vazhduar aktivitetin kriminal të trafikut të drogës në Vlorë dhe mbarë Shqipërinë, për të vazhduar aktivitetin kriminal të pastrimit të parave të pista të krimit dhe të drogës, nëpërmjet aktiviteteve kriminale të pikave të basteve, të lojërave të fatit dhe të ndërtimeve në Shqipëri, në Maqedoni e gjetkë.

Kanë kaluar katër javë dhe asnjë masë nuk është ndërmarrë nga prokuroria, asnjë distancim nga pushteti, nga Edi Rama dhe nga vëllai i ministrit të Brendshëm, i cili për faqen e zezë të vendit dhe turpin e pashlyeshëm të kësaj qeverie, mbetet rasti unik dhe i vetëm në botë, ku ministri, përgjegjës për të zbatuar ligjin e antimafiles, është vetë subjekt i ligjit të antimafiles.

U bënë katër javë që Edi Rama dhe Fatmir Xhafaj u japin mbrojtje dhe mbështetje të përditshme krimit, trafikut dhe bandave të lidhura me qeverinë. Tahiri sot është në liri. Xhafaj mungon, sepse nuk i del koha ngaqë po merret me shkatërrimin e provave, intimidimin e dëshmitarëve, kërcënimin e gazetarëve,urvejimin e opozitës dhe joshjen me qindra mijëra euro të drogës të cilitdo që mendon se mund ta nxjerrë nga halli i madh që i ka rënë në kokë.

Kapja e prokurorisë, presioni i vazhdueshëm mbi drejtësinë, i denoncuar edhe nga partnerët tanë strategjikë, janë vepra të drejtpërdrejta të një njeriu, i cili është urdhëruesi dhe arkitekti i lirim të Saimir Tahirit, i mbajtjes së Xhafës në krye të Ministrisë së Brendshme dhe i mbështetjes së vazhdueshme, përkrahjes pa kufi ndaj bandave dhe organizatave kriminale,

me të cilat e ka lidhur fatin e vet politik. Për Tahirin, për Xhafajn, por në esencë për veten, Edi Rama po bllokoi integrimin evropian të Shqipërisë. 6 javë më parë, në Berlin e mori të qartë mesazhin se negociatat rrezikohen nga ajo që konsiderohet si luftë e pamjaftueshme ndaj krimit dhe korrupsionit, nga kapja e shtetit dhe moszbatimi i ligjit, nga fakti që politikanëve të provuar si të lidhur me krimin, Edi Rama u jep mbrojtje dhe mbështetje, duke shkelur rregullat e parlamentit, Kushtetutën dhe ligjet, duke e shndërruar parlamentin në gjykatë, siç bëri për Saimir Tahirin. Është e papranueshme për Europën të ulet në tavolinën e bisedimeve me një vend që ka në krye një qeveri, që e renditi vendin në 20 më të korruptuarit e botës.

Pas kthimit nga Berlioni, për t'u hedhur hi syve dhe, në përputhje të plotë me paktin e paralajmëruar nga opozita, Rama-Tahiri, ky i fundit vrapoi, sa iu mbajt fryma, për të mos djegur mandatin. Vetëm një javë më parë, papritur, pas një takimi kokë më kokë me Edi Ramën në Tiranë, të dokumentuar nga burime të besueshme dhe prova të pakontestueshme nga opozita, dha dorëheqjen. Dha dorëheqjen pasi mori garancitë se do të dorëzohej në mënyrë të kontrolluar te drejtësia nën thundrën e Edi Ramës. Dhe kështu ndodhi. 10 ditë arrest shtëpie, birra dhe qofte në ballkon dhe tani liri totale për Saimir Tahirin, ministrin e Brendshëm, i cili për 4 vjet e shndërroi Shqipërinë në strehë të krimit të organizuar, në prodhuesen dhe eksportuesen kryesore të kanabisit dhe pikë kyçe për trafikun e kokainës dhe heroinës.

Burg për kuksianët, azil politik e përndjekje për Dritan Zaganin! I njëjti skenar po ndiqet, por tashmë me përmasa thellësisht më kriminale, për të shpëtuar vëllezërit Xhafaj nga drejtësia. I njëjti arkitekt, i njëjti urdhërues.

Edi Rama, ti i ke shpallur me veprimet, vendimet dhe mosveprimet e tua marrjen në mbrojtje shtetërore të vëllezërve Xhafaj, Agronit, i dënuar me 7 vjet e 2 muaj burg, dhe vëllanë e tij, akoma ministër i Brendshëm, për faqen tënde të zezë, Fatmir Xhafaj, njësoj siç bëre me Habilajt dhe Tahirin.

Edi Rama, ti i ke mundësuar Fatmir Xhafajt që t'i sigurojë vëllait trafikant lirinë në Shqipëri,

edhe pse duhej të ishte në burg prej pesë vjetësh, sipas vendimeve të autoriteteve italiane.

Edi Rama, ti bën sikur nuk sheh, dje dhe sot, që ligji antimafia nuk zbatohet, sepse nuk e zbaton autoriteti përgjegjës, Fatmir Xhafaj, i cili në një moment të vetëm ndershmërie, në 40 e ca vjet të karrierës së tij politike, që nga Partia e Punës, si hetues i Sigurimit të Shtetit dhe sekretar i rinisë komuniste, si ministër Drejtësie dhe si ministër i Brendshëm, pohoi se teorikisht e kap ligji antimafia, por praktikisht jo. Praktikisht, e kishte fjalën për ty, Edi Rama, për mbështetjen që i jep ti, që ligji të mos jetë i barabartë për të gjithë, sepse një qytetar pa mbështetje politike, pa lidhje me politikanët, me të pushtetshmit, me të fortët, gjobitet, shoqërohet në polici, keqtrajtohet, dhunohet, shtyhet drejt vetëvrasjes, torturohet dhe vritet, por jo vetëm që nuk e bën këtë për një njeri që sot duhej të ishte nën kontrollin rigoroz të ligjit antimafia, por e pengon qëllimisht nga pozitat e ministrit të Brendshëm.

Edi Rama, ti dhe Fatmiri u kujdesët që Agroni të vazhdonte me aktivitetin kriminal të drogës. Natyrisht, s'kishte pse të pendohej, me burg u dënua, por asnjë ditë nuk bëri. Natyrisht nuk kishte përse të demotivohej, ligji antimafia nuk ia merr pasuritë e krijuara përmes drogës dhe krimit.

Ti, Edi Rama, njësoj si me Saimir Tahirin, vendose të bësh dorëzimin e kontrolluar të Agron Xhafajt. E largove në fshehtësi dhe me urgjencë, për t'ia fshehur drejtësisë në Shqipëri dhe për të manipuluar procesin penal ndaj tij. Këtë vendim, ti, Edi Rama, e shpalle publikisht vetëm disa orë pasi shqiptarët dëgjuan qartë dhe pastër, pa asnjë dyshim, materialet e siguruara nga hetimi gazetaresk se Agron Xhafaj e vazhdon aktivitetin e tij kriminal edhe gjatë kohës që vëllai i tij është ministër i Brendshëm dhe ti, zgërdhirësi i madh, je Kryeministër.

Largimi në fshehtësi dhe me urgjencë i Agron Xhafajt është ekspertiza më e qartë se ti, Edi Rama, ke pasur dijeni për trafikun e drogës nga Agron Xhafaj.

(I ndërpritet fjala, se i ka mbaruar koha në dispozicion.)

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Basha!

Ju mbaroi koha.

Fjalën e ka Taulant Balla. Të përgatitet Luan Rama.

Taulant Balla – Zoti Kryetar,

Kolege dhe kolegë deputetë,

Kuvendi i Shqipërisë sot merr një vendim të rëndësishëm për ngritjen e Fondit Shqiptar për Diasporën, i cili është në vijim të përpjekjeve tona, më në fund, pas 27 vjetësh, dhe po bën gjithçka që ua ka borxh shqiptarëve që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe shqiptarëve të cilët janë kthyer në Shqipëri dhe i janë futur politikës.

Në fillim të vitit nisi punë Agjencia Kombëtare për Diasporën, ndërkohë që në prill të këtij viti miratuam projektligjin “Për diasporën”. U kemi borxh shqiptarëve që jetojnë jashtë territorit. Do t'i qëndrojmë fjalë për fjalë angazhimit që kemi marrë për shqiptarët, që jetojnë jashtë territori, sepse duam që, bashkë me opozitën, të bëjmë edhe ndryshime në Kodin Zgjedhor për t'u dhënë shqiptarëve që jetojnë jashtë territorit të drejtën e votës. Ua kemi borxh, sepse jemi një komb, ku më shumë se gjysma e popullit jeton jashtë territorit, ndaj në vendimet që duhet të marrim për Shqipërinë, duhet të përfshijmë edhe ata që janë sot në emigracion.

Unë dua ta përsërisë ministrin Majko për punën e shkëlqyer në drejtimin e Ministrisë për Diasporën. Për herë të parë në këta 27 vjet, një përfaqësues i qeverisë ka marrë rugën për të shkuar në çdo cep të globit për të takuar shqiptarët që jetojnë në ato vende. Ky është një angazhim, është një borxh, prandaj unë do ta ftoja sot opozitën të bashkohet me ne jo vetëm për hapjen e negociatave, por edhe për t'u qëndruar pranë shqiptarëve që jetojnë kudo nëpër botë.

Ata janë modeli më i mirë. Përpjekja për t'i nxirë komunitetet shqiptare që jetojnë jashtë territorit të Shqipërisë, duke i etiketuar si burim kriminaliteti, është e dështuar. Shqiptarët që jetojnë jashtë territoreve të Shqipërisë janë një mënyrë e mirë për të konceptuar rolin që ata mund të luajnë në Shqipëri.

Kjo iniciativë për krijimin e Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës është mënyra më e mirë se si shqiptarët që jetojnë jashtë territoreve mund të ngrenë së bashku një fond për çështje filantropike, për bamirësi në çdo cep të Shqipërisë.

Duke e konsideruar fjalën time të mbyllur, zoti Kryetar, mua më vjen keq për prirjen e Lulzim Bashës dhe të PD-së për të bllokuar

punimet e Kuvendit, kur sot përsëri do të marrim një vendim të rëndësishëm. Pas këtij vendimi kemi një projektligj të rëndësishëm, një marrëveshje tjetër me Gjermaninë për investime të rëndësishme në infrastrukturë.

E treta, meqenëse jemi te diaspora, lidhur me keqinterpretimet që një deputet sapo ka bërë jashtë sallës së Kuvendit, i them shumë qartë: “Makthi yt, Sali, për marrëveshjen e detit me Greqinë nuk të shpëton dot. I vetmi tradhtar për marrëveshjen me Greqinë je vetëm ti, Sali”.

Faleminderit!

(Deputetët e opozitës mbajnë të bllokuar foltoren.)

Gramoz Ruçi – Kolegë deputetë, uluni që të vazhdojnë debatet për projektligjin, ndryshe jam i detyruar të hedh në votim ndërprerjen e debatit, se Kuvendit për të zhvilluar debat dhe për të miratuar projektligjet që ka në axhendë.

Në kushtet kur uzurpohet foltorja, jam i detyruar të ndërpres diskutimet.

Votojmë me kartonë.

Kush është dakord?

Ndërpriten diskutimet.

Të na falin qytetarët shqiptarë, të na falë diaspora dhe emigrantët tanë, që ishin të interesuar për të dëgjuar mendimet dhe çfarë risish sjell ky projektligj, si dhe marrëveshjet e tjera që kemi në vijim.

Hapet votimi me elektronikë për prezencën.

Mbyllet votimi.

73 deputetë janë të pranishëm.

Fillojmë me projektligjin “Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës”.

Hapet votimi me elektronikë në parim.

Mbyllet votimi.

73 vota pro.

Miratohet.

Kalojmë në votimin nen për nen, me kartonë.

(Votohet varianti integral i përgatitur nga komisioni përgjegjës.)

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 3. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 4. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 5. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

(Ndiket e njëjta procedurë votimi nga neni 6 deri te neni 18, sipas variantit integral të paraqitur.)

Kalojmë në votimin në tërësi.

Hapet votimi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

74 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet projektligji “Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës”.

Vazhdojmë me projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e Lokarnos “Për përcaktimin e një klasifikimi ndërkombëtar për dizenjot industriale””.

Hapet votimi me elektronikë në parim.

Mbyllet votimi.

74 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet në parim.

Kalojmë në votimin nen për nen, me kartonë.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Hapet votimi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

74 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet në tërësi projektligji.

Kalojmë te projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e Vjenës “Për klasifikimin ndërkombëtar të elementeve figurative të markave tregtare””.

Hapet votimi në parim, me elektronikë.

Mbyllet votimi.

74 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet në parim.

Kalojmë në votimin nen për nen, me kartonë.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Hapet votimi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

74 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet në tërësi projektligji.

Hapet votimi për kalendarin trejavor të punimeve të Kuvendit për periudhën 18 qershor – 6 korrik 2018.

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË ENJTE, 7 QERSHOR 2018

Ju njoftoj se dje, në datën 06.06.2018, u mbledh Konferenca e Kryetarëve, e cila diskutoi rreth kalendarit trejavor për periudhën në vijim. Opozita i bojktoi punimet e Konferencës. Për pasojë, në mbështetje të nenit 27, pika 4, të Rregullores, e hedhim në votim.

Kush është dakord me kalendarin?

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Pika e fundit është rezoluta e AMA-s.

Hapet votimi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

74 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet.

(Deputetët e opozitës vazhdojnë të mbajnë të bllokuar foltoren e parlamentit.)

Tani mund të vazhdojë shfaqja nëpërmjet Facebook-ut, se kjo është zgjedhja dhe përzgjedhja e opozitës.

Faleminderit!

Ditën e mirë!

(Seanca u mbyll në orën 12: 15.)

Kryetari i Kuvendit

Gramoz Ruçi

**Drejtori i Shërbimit të Botimeve
Parlamentare
Krenar Hajdëri**